

# **STATUTI**

## **I**

### **SHOQERISE**

### **FABA OIL**

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar

Në këtë statut

- “Ligj” është ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”,
- “Statut” është Statuti I shoqërisë.

#### **Kreu I**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

#### **Neni 1**

##### **Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

1. Sot, më 12/10 / 2023, ne, themeluesit kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **FABA OIL** SH.P.K.

2. Themeluesi e shoqërisë eshte:

**Z.Arjan Sollaku** e Dtl. 30.08.1986 lindur ne Elbasan dhe banues ne Elbasan me karte indetiteti nr. I60830012E

#### **Neni 2**

##### **Objekti**



**Tregeti me pakice te karburanteve, vajrave lubrifikant.**

### **Kohëzgjatja**

**Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë do jete per nje peridhe me shume se 10-vjet.**

### **Neni 4**

#### **Selia**

1.Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: **Elbasan, fshati Hajdaran, rruga Hajdaran-Elbasan km-1, zk.1919, pasuria nr.79/21/2.**

#### **Kreu II**

#### **Kapitali**

### **Neni 5**

#### **Kapitali themeltar**

- 1.Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **100000 lekë**.
- 2.Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tij të mëposhtem:
  - a. Ortaku themelues **Arjan Sollaku** Zotëruese i **1 kuote** me vlerë të përgjithshme **100000 leke** që përbën **100%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

### **Neni 6**

#### **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë,



nëpërmjet emerimit nga gjykata kompetente të një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njejtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njejtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

### **Neni 7**

#### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen npërmjet:

- a.Kontributet në kapitalin e shoqërisë,
- b.shitblerjes
- c.trashëgimisë
- ç. Dhurimit
- d. çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në këtë statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### **KREU III**

#### **ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE**

### **Neni 8**

#### **Organi Vendimmarrës**

Asambleja e ortakëve është organi I vetëm vendimmarrës I shoqërisë.



Asambleja e ortakëve është organi I vtëm vendimmarrës I shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modalitetave të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:

- a. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë,
- b. ndryshimin e statutit,
- c. emërimin dhe shkarkimin e administratorëve,
- ç. Emërimin dhe shkarkimin e likujduesëve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar,
- d. përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronja “c” dhe “ç” të kësaj pike,
- dh. Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë,
- e. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë,
- ë. Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit,
- f. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre,
- g. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve,
- gj. Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë,
- h. miratimin e rregullave procedural të mbledhjeve të asamblesë,
- i. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statute.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person I tretë.



Administratori I shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues I ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asambleës së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njejtin rend dite.

## Neni 9

### **Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asambleës së Përgjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse është e mundur me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asambleës.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

## Neni 10

### **Kuorumi**

Në rastin e marres së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme, mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ajo und të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votive, janë të pranishëm personaliisht, votojnë me shkresë, apo me mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesë së kuorumi të përmendur më lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njejtin rend dite.

## Neni 11



## **Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votive të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zgjedhimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votive të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

- a.përcaktimi I politikave tregtare të shoqërisë;
- b.emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c.emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç.përcaktimin e shpërblimeve;
- d.mbijetësirjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e.përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f.miratimin e rregullave procedural të mbledhjes së asamblesë.

Çdo ndryshim statute duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

## **Neni 12**

### **Përjashtimi nga e drejta e votës**

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a.vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b.Shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c.ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;



ç.dhënien ose jot ë përfitimeve të reja.

2.Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues I autorizuar, I autorizuari vlerësohet të jetë në të njejtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### Neni 13

#### Administrimi

1.Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administrator të shoqërisë. Afati i emërimit, është **5 vjet**, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi I administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

2.Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administrator të një shoqërie të kontrolluar dhe anasjelltas. Çdo emërim I bërë në kundërshtim me këto dispozita është I pavlefshëm.

3.Personat e mëposhtëm caktohen si administrator të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit

nënshkrimi

**Emër, mbiemër ,**



**Arjan Sollaku**

### Neni 14

#### Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

a.kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b.përfaqësojnë shoqërinë tregtare;

c.kujdesen për mbajtjen saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;



ç.përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e  
ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve,  
I paraqesin këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;

d.krijojnë një system paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë  
mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh.kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç  
parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e.raportojnë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave  
tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për  
veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë.kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet  
kur:

a.sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose  
ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk I mbulojnë detyrimet e kërkueshme  
Brenda 3 muajve në vazhdim.

b.shoqëria propozon të shesë ao të disponojë në mënyrë tjetër active, të cilat kanë  
një vleë më të lartë se 5% e aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit  
financiare të certifikuara.

c.shoqëria, brenda 2 viteve të para pas egjistrimit të saj, propozon të blejë nga një  
ortak pasuri që kanë vlerë më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë, që rezulton në  
pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e  
administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me  
shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë  
të marrdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në  
fuqi.

**Neni 15**



## **Përgjegjësitë e administratorit**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, statutit apo për vepra të tjera të kryera me faj gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidare, sipas rastit.

Përveç sa parashikohet në dispozitat e përgjithshme për detyrimin e besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17, dhe 18 të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, administrator detyrohet:

1.
  - a. të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të lartë të shoqërisë në tërsi;
    - b. të ushtrojë kompetencat që I njihen me ligj dhe në statut vetëm për qëllimet e përcaktuara në këto dispozita.
    - c. të vlerësojë me përgjegjshmëri çështjet për të cilat merret vendim;
    - ç. të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, present apo të mundshëm, të interesave personale me ato të shoqërisë;
    - d. të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhekujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimin e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
3. Nëse administratoti vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit, është I detyruar të dëmshpërbujejë dëmet e shkaktuara shoqërisë, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe të kalojë çdo fitim personal që ai/ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta.

Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë.



4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administrator është I detyruar të dëmshpërblejë shoqërinë për dëme të shkaktuara, nëse në kundërshtim me ligjin, kryen veprimet e mëposhtme:

- a. u kthen ortakëve kontributet;
- b. u paguan ortakëve interesa apo dividentë;
- c. shpérndan aktivet e shoqërisë;
- ç. lejon që shoqëria të vazhdojë veprimitarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d. jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që I ngarkohet personalisht administratotit, ortakët individualisht ose sëbashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërbimin financier nëse është e nevojshme. Asnjë vendim I asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### **Kreu IV**

##### **Viti finanziar/ekspertët**

###### **Neni 16**

###### **Viti finanziar**

Viti finanziar I shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor.

Përjashtimisht, viti I parë finanziar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllt më 31 Dhjetor.

###### **Neni 17**

###### **Ekspertët**



Eksperti ka për detyrë të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë vjetor dhe kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë, I ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit, eksperti kontabël I licensuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finansiar vjetor, si dhe atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është I detyruar t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'I shqyrta e miratuar mbi bazën e së drejtës së votës që kanë.

## Kreu V

### Prishja/riorganizimi I shoqërisë

#### Neni 18

##### Prishja dhe Likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a. kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
- b. me vendim të asamblesë së ortakëve;
- c. me hapjen e procedurave të falimentit;
- d. nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi I veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- e. me vendim të gjykatës.

Në këtë rast, ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe duke shënuar në çdo document të ndxjerrë prej saj emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “shoqëri në likuidim e sipër”.

Prishja e shoqërisë tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuidatorët e emëruar nga ortakët.



Nëse ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuidatorëve, Brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person I interesuar mun t’I drejtohet gjykatës për të caktuar një likuidues.

### **Neni 19**

#### **Riorganizimi I shoqërisë, bashkimi/ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas vendimit të mbledhjes së përgjithshme të asamblesë së ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në pjesën IX të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”.

### **Neni 20**

#### **Baza ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar në fuqi.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specific në Republikën e Shqipërisë.

### **Neni 21**

#### **Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statute, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve të treat dhe shoqërisë, kompetenca lëndore I takon gjykatave shqiptare.

Ortaku i vetem i shoqërisë **FABA OIL** sh.p.k.

**Arjan Sollaku**

